REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
329/20
Data/Datum. 26.06.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH .nr.329/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "BK-CONSTRUCTION SH.P.K"-Pejë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "Serena", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rehabilitimi i gypit të vjetër të AC, Dn 200 të ujësjellësit jugor", me nr. të prok: "HIDRO-199346-5-2-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini" SH.A. – Pejë, më datën: 25.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET , si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "BK-CONSTRUCTION SH.P.K"-Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rehabilitimi i gypit të vjetër të AC, Dn 200 të ujësjellësit jugor", me nr. të prok: "HIDRO-199346-5-2-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini" SH.A. – Pejë.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rehabilitimi i gypit të vjetër të AC, Dn 200 të ujësjellësit jugor", me nr. të prok: "HIDRO-199346-5-2-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini" SH.A. – Pejë dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "BK-CONSTRUCTION SH.P.K"-Pejë, aprovohet si e bazuar, ankuesit i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI . Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "BK-CONSTRUCTION SH.P.K"-Pejë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 27.05.2020 me nr.329/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rehabilitimi i gypit të vjetër të AC, Dn 200 të ujësjellësit jugor", me nr. të prok: "HIDRO-199346-5-2-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini" SH.A. – Pejë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 69 paragrafi 6 pika 6.1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe nenin 39 pika 8 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.06.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 12.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr.1, Eksperti shqyrtues, sa i përket pretendimit te OE ankues, se i rekomanduari për kontrate nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit lidhur me Inxhinierin e Gjeodezisë, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar diplomë te Inxhinierit te Gjeodezisë me gradë te Bachelor-it dhe se sipas OE ankues nuk është e njëjta gradë e diplomës me atë qe ka kërkuar AK-Hidrodrini ne dosje te tenderit. Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne kërkesën e dosjes se tenderit, vlerëson se pretendimi i OE ankues është i paqëndrueshëm për faktin se, AK-ja, ne dosje te tenderit nuk ka kërkuar gradë Bachelor ose Master. Ne kërkesën e dosjes se tenderit lidhur me inxhinierin e lartpërmendur thuhet vetëm se i njëjti duhet te jetë i drejtimit te Gjeodezisë dhe i diplomuar me 3 vite përvoje pune dhe nuk përmenden gradat Bachelor apo Master.

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me CV-in për te cilën pretendon se CV e inxhinierit te

gjeodezisë nuk i përmban te dhënat e nevojshme, eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se OE i rekomanduar për kontrate me rastin e aplikimit ne ketë aktivitet te prokurimit nuk e ka dorëzuar ne ofertën e tij CV-in e inxhinierit te Gjeodezisë dhe për te njëjtën AK-ja gjate vlerësimit ka kërkuar sqarim nga OE i rekomanduar për kontrate dhe i njëjti e ka dorëzuar CV-in e Inxhinierit te lartpërmendur. Eksperti shqyrtues, ne vazhdim sqaron se ne CV-in, e inxhinierit është dhëne përvoja e punës prej vitit 2010 deri ne vitin 2016 ne kompani te ndryshme dhe për te njëjtat ka dorëzuar edhe referenca si gjeodet, por te njëjtat nuk mund te merren parasysh per faktin se data e diplomimit te inxhinierit te Gjeodezisë është Korrik 2015 dhe nuk mund te merret si përvoje profesionale për faktin se nuk ka qene i diplomuar si inxhinier. Po ashtu lidhur me përvojën e inxhinierit te Gjeodezisë ne CV, është shënuar se ky inxhinier prej vitit 2016 punon ne një kompani tjetër po qe nuk ka te dhëna te mjaftueshme, se sa ka punuar ne ketë kompani dhe nuk ka dorëzuar as reference nga kjo kompani, reference me te cilën do ta mbulonte për faktin se diplomimi i Inxhinierit te Gjeodezisë është Korrik 2015 dhe vetëm nga ajo date mund te llogaritet përvoja profesionale. Prandaj, pretendimi i OE ankues lidhur me dëshmitë e lartpërmendura qëndron për faktin se ne CV e Inxhinierit te gjeodezisë mungojnë te dhënat e nevojshme për ta vërtetuar përvojën e Inxhinierit te lartpërmendur, andaj konform nenit 39 RRUOPP-se pikës 10 te tabelës se dhëne ne këtë nen është dashur qe ofertën e te rekomanduarit për kontrate ta refuzoje për faktin se përkundër mundësisë se dhëne për sqarim nga AK-ja, OE i rekomanduar për kontrate nuk ka arritur te dëshmoje se i njëjti e plotëson kërkesën lidhur me përvojën e inxhinierit te Gjeodezisë, pra CV-ja e dorëzuar nuk e përmbush kërkesën e AK-se.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-se, për dhënie te kontratës te anulohet dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 12.06.2020, me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo të njëjtit nuk kane kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik, me datë: 15.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankes eshte parashtruar kunder Njoftimit per dhnie te kontrates.

Lidhur me pretendimin e ankuesit , se OE i rekomanduari për kontrate nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit lidhur me Inxhinierin e Gjeodezisë, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar diplomë te Inxhinierit te Gjeodezisë me gradë te Bachelor-it dhe se sipas OE ankues nuk është e njëjta gradë e diplomës me atë qe ka kërkuar AK-Hidrodrini ne dosje te tenderit.

Paneli shqyrtues konstaton se duke u bazuar ne kërkesën e AK –së , per Inxhinjer te Gjeodezis kuptohet se vete fjala Inxhinjer i Gjeodezis ka te beje me nje person qe eshte me nivel te studimeve te sistemit te vjeter 5 vjeçar apo niveli te studimeve bachelor dhe perfundimin e studimeve Master –sistemi 3+2 (sistemi Bachelor dhe Masteri),andaj nuk mund te merret se eshte plotesuar kerkesa e AK-së, e cekur si me lart, nga OE i rekomanduar per dhnei te kontrates per faktinse OE në fjale ka ofruar diplome të Inxhinierit te Gjeodezisë me gradë te Bachelor-it, duke mos i bashkangjitur kesaj diplome edhe diplomen e masterit per te njëjtin inxhinier.

Pra paneli shqyrtues konstaton se per tu plotesuar kerkesa e AK-së, per inxhinierin e gjeodezis, ofertuesit duhet te ofronin ose diplome te studimeve 5 vjeçare ose diplome te studimeve bachelor 3 vjeçare dhe diplomen e Masterit per te njejtin inxhinier.

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me CV-in për te cilën pretendon se CV e inxhinierit te gjeodezisë e ofruar nga OE i rekomanduar per dhnei te kontrates nuk i përmban te dhënat e nevojshme.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se fillimisht sqarojm se OE i rekomanduar për kontrate me rastin e aplikimit ne ketë aktivitet te prokurimit nuk e ka dorëzuar ne ofertën e tij CV-in e inxhinierit te Gjeodezisë dhe për te njëjtën AK-ja gjate vlerësimit ka kërkuar sqarim nga OE i rekomanduar për kontrate dhe i njëjti e ka dorëzuar CV-in e Inxhinierit te lartpërmendur.duke kerkuar sqarime per CV-ne fjale AK ka vepruar ne pajtim me nenin 39.8 te RRUOPP , (në te cilin nen thuhet: CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar - Mund te kërkohen informata sqaruese -69)

Paneli shqyrtues konform ekspertiti shqyrtues konstaton, se në CV-in, e inxhinierit te cekur si me lart është dhëne përvoja e punës prej vitit 2010 deri ne vitin 2016 ne kompani te ndryshme dhe për te njëjtat ka dorëzuar edhe referenca si gjeodet, por te njëjtat nuk mund te merren parasysh per faktin se data e diplomimit te inxhinierit te Gjeodezisë është Korrik 2015 dhe nuk mund te merret si përvoje profesionale për

faktin se nuk ka qene i diplomuar si inxhinier. Po ashtu lidhur me përvojën e inxhinierit te Gjeodezisë ne CV, është shënuar se ky inxhinier prej vitit 2016 punon ne një kompani tjetër po qe nuk ka te dhëna te mjaftueshme, se sa ka punuar ne ketë kompani dhe nuk ka dorëzuar as reference nga kjo kompani, reference me te cilën do ta mbulonte për faktin se diplomimi i Inxhinierit te Gjeodezisë është Korrik 2015 dhe vetëm nga ajo date mund te llogaritet përvoja profesionale. Prandaj, paneli konstaton se pretendimi i OE ankues lidhur me dëshmitë e lartpërmendura qëndron për faktin se ne CV e Inxhinierit te gjeodezisë mungojnë te dhënat e nevojshme për ta vërtetuar përvojën e Inxhinierit te lartpërmendur, andaj konform nenit 39 RRUOPP-se pikës 10 te tabelës se dhëne ne këtë nen është dashur qe ofertën e te rekomanduarit për kontrate ta refuzoje për faktin se përkundër mundësisë se dhëne për sqarim nga AK-ja, OE i rekomanduar për kontrate nuk ka arritur te dëshmoje se i njëjti e plotëson kërkesën lidhur me përvojën e inxhinierit te Gjeodezisë, pra CV-ja e dorëzuar nuk e përmbush kërkesën e AK-se.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve per aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk është bërë konform nenit 7dhe 59 të LPP-së . Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini" SH.A. – Pejë

1x1 OE –"BK-CONSTRUCTION SH.P.K"-Pejë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.